

KOMUNA
E FERIZAJT

PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT 2017-2021



**PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT I
KOMUNËS SË FERIZAJIT
2018-2022**

Komuna e Ferizajit
Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Ferizajit 2018-2022

Ky dokument u miratua nga Kuvendi i Komunës së Ferizajit në mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2018.



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menažuuar
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Ky plan është hartuar me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "Rrjeti i Kosovës për Arsimit dhe Punësim - KEEN", që menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti zbatohet nga Qendra për Arsimit dhe Punësim (KEC) në bashkëpunim me Agjencinë për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Akademinë e Trajtimeve dhe Asistencës Teknike (ATTA) dhe Stichting SPARK. Pëmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si refleksim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	9
Përmbledhje ekzekutive	11
1. Hyrje	12
2. Sfondi.....	13
2.1. Arsimi në Komunën e Ferizaj	13
2.2. Analiza e gjendjes	13
2.2.1. Menaxhimi i arsimit dhe administrata	14
2.2.2. Sigurimi i cilësisë	15
2.2.3. Zbatimi i kurrikulës së re.....	15
2.2.4. Zhvillimi profesional i mësimeve	16
2.2.5. Mjedisi shkollor.....	17
3. Qasja strategjike.....	18
3.1. Vizioni dhe misioni.....	18
3.2. Objektivat strategjike dhe masat	18
3.2.1. Menaxhimi dhe administrata	22
3.2.2. Sigurimi i cilësisë	24
3.2.3. Zbatimi i kurrikulës së re.....	26
3.2.4. Zhvillimi profesional i mësimeve	28
3.2.5. Infrastruktura shkollore	30
3.3. Analiza e rrezikut	30
4. Plan i veprimit dhe buxheti	32
5. Komiza për vlerësimin e performancës	<u>44</u>

Lista e shkurtesave

AAAPARR	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
APPK	Agjencia për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë
ATTA	Akademia e Trajnimeve dhe Asistencës Teknike
BEP	Programi i Arsimit Themelor (Basic Education Program)
BPV	Bruto Produkti Vendor
BSFK	Ballkan Sunflowers Kosova
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
GiZ CDBE	Zhvillimi i kapaciteteve në arsimin themelor
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
KFOS	Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OS	Objektiva Strategjike
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës
SPARK	Organizatë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë dhe Ndërmarrësisë
SWOT	Analiza e Suksesit, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve
ShMU	Shkollë e Mesme e Ulët
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
USAID	Agjencioni i ShB për Zhvillim Ndërkombëtar
ZhPMI	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Përmbledhje ekzekutive

Plani Zhvillimor i Arsimit për Komunën e Ferizajt 2018-2022 është rezultat i bashkëpunimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit të Ferizajit dhe Rrjetit të Kosovës për Arsime dhe Punësim (KEEN), koalicion strategjik i katër organizatave të shoqërisë civile të cilat angazhohen në fushën e arsimit, punësimin dhe të politikave sociale. Ky plan zhvillimor komunal është hartuar përmes një procesi të strukturuar dhe me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, duke u mbështetur në nevojat reale për zhvillimin e arsimit në Komunën e Ferizajit, si dhe në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe dokumentet e tjera nën sektoriale. Plani është përqendruar në pesë fusha të cilat u përcaktuan pas konsultimeve të brendshme në formë të punëtorisë:

- Menaxhimi i arsimit dhe administrata
- Sigurimi i cilësisë
- Implementimi i kurrikulës së re
- Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve
- Mjedisi shkollor

Pas përcaktimit të fushave të planit është realizuar analiza e gjendjes përmes metodologjisë SWOT, si dhe janë mbledhur të dhëna që shërbyen për qëllime të planifikimit. Të dhënat janë siguruar nga dokumentet ekzistuese të DKA-së dhe MASHT-it. Pas kësaj është përcaktuar vizioni dhe misioni i Planit Zhvillimor, si më poshtë:

Vizioni: Rritja e mirëqenies në komunën e Ferizajt përmes arsimit cilësor të gjeneratave të reja në funksion të zhvillimit të burimeve njerëzore, të ekonomisë, si dhe të ngrijës së cilësisë së shërbimeve për qytetarë.

Misioni: Ofrimi i arsimit cilësor për të gjithë nxënësit e komunës së Ferizajt përmes promovimit të mësimitdhënës bashkëkohore dhe nxitjes së llogaridhënies.

Plani Zhvillimor i Arsimit ka pesë **objektiva strategjike**, nga një për secilën fushë me interes:

- OS1. Menaxhimi efikas i arsimit
- OS2. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë në institucionet edukativo-arsimore
- OS3. Përgatitje cilësore dhe zbatim profesional i kurrikulës
- OS4. Mësimitdhënës të zhvilluar profesionalisht sipas standardeve
- OS5. Mjedisi tërheqës dhe i sigurt shkollor

Pas kësaj faze, përmes punëtorive janë përcaktuar dymbëdhjetë (12) masat që çojnë në arritjen e pesë (5) objektivave strategjike. Po ashtu është zhvilluar analiza e rrezikut e cila identifikon masat parandaluese për rreziqet e mundshme për zbatimin e Planit Strategjik. Në fazën e fundit të procesit është hartuar plani i veprimit dhe buxheti për periudhën e realizimit të Planit Zhvillimor të Arsimit (2018 – 2022). Vlera e mjeteve të nevojshme për zbatimin e Planit, pa llogaritur shpenzimet operative të zakonshme, arriti shumë prej **€ 11,663,196**. Në këtë shumë përfshihen mjetet vetanake nga Komuna dhe nga Buxheti qendror ose nga donatorët. Krejt në fund, plani përmban komizën për vlerësimin e performancës me treguesit dhe caqet e synuara mbi bazën e të cilëve do të vlerësohet progresi i realizimit të këtij plani.

2. Sfondi

2.1. Arsimit në Komunën e Ferizajt

Komuna e Ferizajt është ndër komunat më të mëdha në Republikën e Kosovës. Komuna e Ferizajt ka 345 km², që përfshin qytetin dhe 45 fshatëra rreth tij. Kjo zonë ka një popullsi prej 108,690 banorë. Për nga numri i nxënësve dhe punëtorëve të arsimit, Ferizaj është komuna e tretë pas Prishtinës dhe Prizrenit. Ferizaj ka gjithsej 63 institucione arsimore duke përfshirë 2 institucione parafillore, 53 institucione të arsimit të mesëm dhe të ulët dhe 8 institucione të arsimit të mesëm të lartë¹.

Tabela 1. Lëvizja e numrit të nxënësve në pesë vitet e fundit

Niveli	2012/13	2013/14	2014/15	2015/16
Parashkollor	253	190	374	330
Parafillor	1746	1660	1754	1681
Fillor dhe i mesëm i ulët	19631	18840	18624	17239
I mesëm i lartë	8168	7393	6090	6446
Gjithsej	29798	28083	26842	25696

Buxheti i arsimit në dispozicion është relativisht i kufizuar duke ditur numrin e madh të nxënësve dhe personelit arsimor si dhe nevojën për ndryshime. Tabela 2 më poshtë paraqet pasqyrën e buxhetit në dispozicion nga granti qeveritar dhe të hyrat vetanake.

Tabela 2. Buxheti për arsimin parauniversitar në vitin 2017²

Burimi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencio net dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
Grantet qeveritar e	10,426,363	537,633	124,280		665,000	11,753,276
Të hyrat vetanake	20,000	82,130	1,000	50,000		153,130
Gjithsej	10,446,363	619,763	125,280	50,000	665,000	11,906,406

2.2. Analiza e gjendjes

Procesi i analizës së gjendjes është realizuar duke u bazuar në të dhënat që janë në dispozicion në nivel komunal e po ashtu edhe në bazë të punëtorisë së realizuar për analizën e gjendjes. Ky proces filloi në punëtorinë njëditore që u mbajt më datë 28 prill 2017 me një ekip të caktuar nga DKA në të cilën u bë definimi i fushave që do të përfshihen në analizën e gjendjes dhe përkrahimi i këtyre fushave. Pastaj, më datë 19 Maj 2017 u mbajt një punëtori njëditore, ku u realizua analiza SWOT e fushave të cilat ishin parapraë dhe dakorduar. Në punëtorinë e analizës SWOT u përfshinë palë të ndryshme duke përfshirë zyrtarë të DKA-së, drejtor shkollash dhe mësimdhënës të profileve të ndryshme. Pas këtij procesi, u arrit dakordimi që plani zhvillimor i DKA-s Ferizaj do të duhet të përfshijë këto fusha:

¹ MASHIT, Raporti i SMIA-s 2015/2016.

² Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

1. Hyrje

Nevoja e zhvillimit të Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Ferizajt ka qenë nevojë e identifikuar pas miratimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në kohë të duhur u prezantua edhe oferta për asistencë teknike nga Rjeti Kosovë për Arsim dhe Punësim (KEEN), koalicion strategjik i udhëhequr nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) me katër organizata të shoqërisë civile të cilat angazhohen në fushën e arsimit, punësimin dhe politikave sociale. Rjeti është themeluar në fillim të vitit 2016 me mbështetjen e projektit me emërtim të njëjtë, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe ka për qëllim përmirësimin e punësueshmërisë së grupeve në nevojë në Kosovë dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e politikave, në vendimmarrje dhe në monitorimin e zbatimit të tyre në nivel qendror dhe lokal. Projekti drejtohet nga KEC, ndërsa partnerë janë APPK, BSFK, ATTA dhe organizata holandeze SPARK. Projekti ndihmoi procesin e planifikimit të këtij plani ndërsa në proces u përfshinë të gjitha palët e interesit si zyrtarë të DKA-s, drejtor shkollash, mësimdhënës etj.

Procesi i planifikimit është drejtuar nga Grupi për Planifikim i themeluar nga DKA-Ferizaj dhe u ndihmua nga ekspertët e arsimit të angazhuar nga projekti KEEN. Procesi u karakterizua me pjesëmarrje të palëve me interes dhe konsultime të vazhdueshme, ndërsa u zhvillua në 4 faza kryesore:

Faza 1: Analiza e gjendjes ekzistuese

Grupi për Planifikim i DKA përcaktoi pesë fusha me interes për planifikimin zhvillimor komunal: 1) Menaxhimi dhe administrata; 2) Sigurimi i cilësisë; 3) Zbatimi i kurrikulës së re; 4) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve; dhe 5) Infrastruktura shkollore, të cilat u konsideruan të rëndësishme për zhvillimin e arsimit në komunën e Ferizajt. U mbajtën dy takime në formë të punëtorive për të përcaktuar dhe përkrahur fushat e planit strategjik dhe në bazë të saj u realizua edhe analiza SWOT me pjesëmarrje më të gjërë duke përcaktuar gjendjen aktuale të arsimit.

Faza 2: Përcaktimi i objektivave dhe masave të planit zhvillimor të arsimit

Kjo fazë u realizua përmes një punëtorie dy-ditore me pjesëmarrjen e anëtarëve të Grupit të zgjedhur për planifikim. Në bazë të analizës së gjendjes dhe dokumenteve zhvillimore ekzistuese u përcaktuan vizioni dhe misioni për zhvillimin e arsimit në komunë, si dhe objektivat strategjike dhe masat për arritjen e tyre. Po ashtu, u përcaktuan treguesit e progresit dhe u bë një analizë e rrezikut.

Faza 3: Plani i veprimit dhe buxheti

Në një punëtori njëditore u punua në hartimin e planit të veprimit dhe të buxhetit, ku u shqyrtuan, në mënyrë të gjithanshme mundësitë për zbatim të planit dhe për zotimin e mjeteve buxhetore të nevojshme për këtë qëllim.

Faza 4: Hartimi i dokumentit të Planit Zhvillimor

Në bazë të dokumenteve të hartuara gjatë procesit, në përfundim të tij u hartua edhe drafti i Planit Zhvillimor të Arsimit, i cili, pasi u shqyrtua nga Grupi për Planifikim i DKA-së, mori formën e draftit përfundimtar.

1. Menaxhimi i arsimit dhe administrata
2. Sigurimi i cilësisë
3. Implementimi i kurrikulës së re
4. Zhvillimi profesional i mësimit dhe mësuesve
5. Mjedisi shkollor

Duket se ndarja e fushave të analizës dhe fushëveprimi është shumë e ngjashme me ndarjen e fushave që janë edhe në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021. Ka disa dallime të vogla megjithatë ato nuk janë domethënëse dhe ky plan mund të konsiderohet se është vazhdimësi e PSK 2017 – 2021 në nivel lokal dhe në funksion të zbatimit të tij. Më poshtë do të bëhet edhe një përshkrim i hollësishëm i secilës fushë duke precizuar gjendjen dhe përparësitë aktuale si dhe duke identifikuar mangësitë.

2.2.1. Menaxhimi i arsimit dhe administrata

Shkollat në komunën e Ferizajt përballen me një numër sfidash, porse ka edhe gjëra të cilat konsiderohen se funksionojnë mirë. Aktualisht, shkollat kanë themeluar mekanizmat e ndryshëm të brendshëm të paraparë me legjislacionin në fuqi. Shkollat i kanë të themeluar këshillat drejtues të shkollave, këshillat e prindërve dhe këshillat e nxënësve. Megjithatë, funksionimi i këtyre mekanizmave ka hapësirë ende për avancim dhe përmirësim të efektivitetit të punës së tyre.

Sfidat kryesore:

- Mungesa e funksionimit efektiv të këshillave të shkollës.
- Mungesa e monitorimit nga DKA dhe inspektorët e arsimit.
- Mungesa e aktivitetëve për PIA.
- Numri i vogël i personelit të specializuar në DKA.
- Mungesa e funksionimit të ekipit për parandalim dhe kundër braktisjes së shkollimit, brenda komunës.
- Strukturë joefikase e organizimit të DKA-së.

Në veçanti, ekziston përciptimi që puna e këshillave drejtuese të shkollave mund të avancohet duke ngritur rolin e tyre në avancimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Në këtë kontekst, funksionalizimi i këshillave drejtues duhet të përmirësohet duke fuqizuar rolin e prindërve dhe të përfaqësuesve të komunitetit në këshill drejtues si dhe angazhimin e shtuar të këshillit drejtues në monitorimin e zbatimit të planit zhvillimor të shkollës. Në anën tjetër, shkollat kanë drejtorë që kanë kryer aftësimin profesional për pozita udhëheqëse dhe kjo mund të konsiderohet si përparësi, megjë trajnimet e ardhshme mund të orientohen drejt adresimit të nevojave për përmirësim të aktivitetëve specifike të mësimdhëniesve drejt arritshmërisë së shtuar të nxënësve.

Një element i rëndësishëm i funksionimit të shkollave në komunë është edhe funksionimi i sistemit të arsimit në nivel komunal. Kjo ka të bëjë me aktivitetet që menaxhohen nga drejtoria komunale e arsimit. Lidhur me këtë është edhe funksionaliteti i drejtorisë komunale krahas përgjegjësi të reja të deleguara me ligjin e arsimit në komunë, që u miratua në vitin 2008. Në këtë nivel, sfida mbetet mekanizmi i hartimit të planeve individuale të arsimit për nxënësit me nevojë të veçanta. Po ashtu, e lidhur ngusht me këtë është edhe pamundësia e ofrimit të edukatorëve mbështetës për shkollat që të mbështeten shkollat në ofrimin e mësimit cilësor për fëmijët me nevojë të veçanta. Një çështje tjetër e cila është e lidhur ngusht me punën e DKA-së është edhe mungesa e përshkrimeve të qarta të detyrave të punës për personelin në shkollë duke përfshirë këtu personelin menaxhues dhe administrativ si dhe personelin mësimdhënës.

Në nivel të DKA-së gjithashtu është me rëndësi të shtohet niveli i aktivitetëve në monitorimin e performancës së mësimdhëniesve qoftë në kuadër të sistemit të licencimit të mësimit apo në kuadër të përgjegjësi të DKA-së për monitorim të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë. Në anën tjetër, edhe pse fenomeni i braktisjes nuk është shumë i dukshëm në komunë, DKA ka nevojë të intensifikojë aktivitetet e veta rreth parandalimit të braktisjes përmes funksionalizimit të ekipit komunal për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe bashkëpunimit me ekipet e tilla në nivel shkollë. DKA aktualisht ka 10 punonjës.

2.2.2. Sigurimi i cilësisë

Miratimi i Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë në nivel të shtetit i miratuar në vitin 2016 ka vendosur arsimin në nivel komune para një situatë të re. Kjo situatë kërkon nga niveli komunal të ndërmarrë një sërë aktivitetesh të cilat synohet të sigurojnë një sistem funksional të sigurimit të cilësisë. Në komunë tashmë janë ndërmarrë disa aktivitete në kuadër të zbatimit të strategjisë së sigurimit të cilësisë. Për shembull, tashmë ekzistojnë kordinatorët e cilësisë në të gjitha shkollat e komunës. Këta koordinatorë tashmë kanë ndjekur trajnimet e ofruara nga Ministria e Arsimit ndërsa ekziston nevoja që të punohet edhe me shumë në fuqizimin e rolit të tyre dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre në këtë fushë. Ngritja e kapaciteteve të koordinatoreve të cilësisë dhe drejtorëve të shkollave duhet të orientohet edhe në drejtim të realizimit të vetëvlerësimit të shkollave në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë të paraparë me ligjin e arsimit parauniversitar. Po ashtu, një vështirësi e theksuar në këtë fushë është edhe pamundësia e funksionalizimit të shërbimit të mirëfilltë pedagogjik dhe psikologjik në shkollë si një nga elementet kryesorë të sigurimit të punës cilësore në nivel shkollë. Sistemi i licencimit në legjislacionin e arsimit është menduar të jetë një element qendror në sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, prandaj sfida e theksuar e DKA-së do të jetë sigurimi i vlerësimit të mirëfilltë të performancës së mësimdhëniesve brenda këtij sistemi të licencimit. Kjo kërkon angazhim, përgatitje dhe procese në nivel komune dhe shkollë për realizim të mirëfilltë të vlerësimit të performancës së mësimdhëniesve.

2.2.3. Zbatimi i kurrikulës së re

Në komunën e Ferizajt ekzistojnë gjithsej 3 shkollë pilotuese të kurrikulës së re të cilat janë përfshirë deri më tani. Megjithatë procesi ka filluar mbarë, duket të ketë akoma mjaft sfida të cilat ndërlidhen me punën e mësimdhëniesve dhe me ofrimin e kushteve për një zbatim efikas. Së pari, ekziston një nevojë e theksuar për të shtuar aktivitetet rreth vetëdijesimit dhe informimit të duhur të të gjitha palëve rreth kurrikulës së re. Me theks të veçantë informimi duhet të bëhet për mësimdhënësit dhe për drejtorët. Në anën tjetër, ekziston nevoja e përkrahjes së mësimdhëniesve me mjete didaktike të cilat do të sigurojnë zbatimin më efikas të kurrikulës së re. Kjo ndihmë duhet të shtrihet në tërë komunën dhe duhet të jetë e

Sfidat kryesore:

- Mungesë e shërbimit pedagogjik në shkollë.
- Mungesë e monitorimit të performancës së mësimdhëniesve.
- Vlerësim jo objektiv i vlerësimit të performancës së mësimdhëniesve.
- Mungesë e kapaciteteve për vetëvlerësim në nivel të shkollës.

Sfidat kryesore:

- Mungesë e informimit të duhur për kurrikulën e re.
- Mungesë e mjeteve didaktike për zbatim të kurrikulës së re.
- Vështirësi në shtetjen e implementimit të kurrikulës së re në tërë komunën.
- Mungesë e literaturës adekuate për zbatim të kurrikulës së re.

vazhdueshme, qoftë me mjete didaktike, apo edhe me aktivitete rutinore vetëdijesuese dhe aktivitete trajnimi. Kjo duhet të kihet parasysh edhe në kontekst të nevojës që zbatimi i kurrikulës së re duhet të shtrihet në tërë komunën dhe kjo do të jetë një nga sfidat kryesore për DKA-në dhe për vetë shkollat në vitet në vijim.

Ndërkaq, sfidë e theksuar është edhe pajisja e shkollave me literaturë adekuate, e cila do të ishte në funksion të zbatimit sa më efikas të kurrikulës së re. Kjo literaturë duhet të përcëptohej me gjerë dhe nuk kufizohet vetëm në ofrimin e teksteve themelore për nxënës. Andaj, komuna do të ketë për fokus ofrimin e të gjitha kushteve duke përfshirë edhe planifikimin e zbatimit të kurrikulës së re në nivel të komunës.

2.2.4. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Komuna ka përvojë në realizimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Në përgjithësi janë organizuar trajnime të ndryshme sikur për të gjithë mësimdhënësit e Kosovës. Por, për të vazhduar tutje, do të duhet të bëhet një analizë e mirëfilltë e nevojave të mësimdhënësve për zhvillim profesional në nivel të komunës duke përfshirë konsultime me mësimdhënësit nga terreni. Në përgjithësi, ekziston mungesë e theksuar e mjeteve financiare për të mbuluar koston e zhvillimit profesional të vazhdueshëm për mësimdhënës. Andaj, për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, DKA duhet të sigurojë buxhetin e vet që ia dedikon shkollave për të siguruar aktivitetet e ndryshme qoftë me bazë në shkollë apo për të siguruar shërbimet e organizatave të ndryshme të trajnimit të mësimdhënësve. DKA ka bashkëpunim të mirë me organizatat e ndryshme të cilat merren me zhvillim e mësimdhënësve dhe do të vazhdojë këtë bashkëpunim, ndërsa sigurimi i mjeteve vetanake do të synojë plotësimin e nevojave themelore të mësimdhënësve që dalin nga zbatimi i kurrikulës së re dhe i reformave tjera në progres.

dhe pse mësimdhënësit në përgjithësi shpresin interesim për zhvillim të vazhdueshëm profesional, DKA duhet të gjejë forma të cilat motivojnë mësimdhënësit të angazhohen në aktivitete të vazhdueshme. Disa kategori të mësimdhënësve kanë ndjekur mjaft aktivitete të ndryshme të seminareve dhe ekziston nevoja që oferta e së ardhmes të ndërtidhet me kërkesat shesë që sjell reforma për mësimdhënësit. Ata duhet të shohin nevojën e angazhimit në këto aktivitete andaj duhet të sigurohen aktivitete të reja të mentorimit që shpiejnë deri tek ideja se aktivitetet e reja do të ofrojnë edhe qasje të reja të cilat shkojnë përtej seminareve klasike dhe se secili mund edhe të kontribuojë përveç se të përfitojë.

Sfidat kryesore:

- Mungesë e vlerësimit të nevojave të mësimdhënësve për zhvillim profesional.
- Mungesë e buxhetit të caktuar për zhvillim profesional.
- Mungesë e kapaciteteve të trajnerëve për zhvillim profesional.
- Mungesë e praktikave të mentorimit dhe monitorimit të mësimdhënësve.
- Mungesë e motivimit të mësimdhënësve për angazhim në zhvillim profesional.

2.2.5. Mjedisi shkollor

Shkollat në komunën e Ferizajt punojnë kryesisht në dy ndërrime. Gjendja e infrastrukturës konsiderohet të jetë e mirë, megjithatë zgjerimi i hapësirës ekzistuese është esencial për të rritur efikasitetin e funksionimit të shkollës dhe punës me nxënës. Në këtë kontekst, rritja e hapësirës për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në edukimin paarashkollor ku nevoja është më e theksuar. Në të njëjtën kohë, ekziston nevoja për të përmirësuar sistemin e mirëmbajtjes së hapësirave ekzistuese shkollore si dhe një sistem i planifikimit të ndërtimeve të reja në bazë të të dhënave nga terreni duke shfrytëzuar të dhënat e MASH për infrastrukturën shkollore. Në fushën e mjedisit shkollor, ekziston sfidë e theksuar e sigurisë në shkolla e në veçanti siguria në shkollat e mesme të larta dhe roli i DKA-së dhe i shkollave është esencial në këtë proces.

Sfidat kryesore:

- Hapësirë e pamjaftueshme shkollore.
- Mungesë e sigurisë në shkolla.
- Mirëmbajtje joadekuate e objekteve shkollore.

3. Qasja strategjike

3.1. Vizioni dhe misioni

Përdërisa ekzistojnë përkufizime të ndryshme për vizionin, në përgjithësi ekziston një i kuptuar i përbashkët se përcaktimi i vizionit për fushën e arsimit ka të bëjë me përcaktimin e gjendjes së dëshiruar në kontekstin e caktuar. Komuna e Ferizajt ka kaluar edhe më herët nëpër procese planifikimi, të cilat kanë përfshirë në vetë përcaktimin e gjendjes së dëshiruar. Duke marrë parasysh edhe Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 dhe nevojat e zhvillimit të Komunës, ky plan përcakton një vizion më gjithëpërfshirës dhe më afatgjatë. Ky vizion është hartuar me idenë që arsimi të jetë në funksion të zhvillimit më gjithëpërfshirës të Komunës, në të gjitha sferat e jetës.

Vizioni: rritja e mirëqenies në komunën e Ferizajt përmes arsimimit cilësor të gjeneratave të reja në funksion të zhvillimit të burimeve njerëzore, të ekonomisë, si dhe të ngrijës së cilësisë së shërbimeve për qytetarë.

Deklarata e misionit nënkupton obligimin që merr komuna për të siguruar realizimin e vizionit të përcaktuar. Komuna e Ferizajt ka përcaktuar si mision ofrimin e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës duke theksuar nevojën e promovimit të mësimdhënies bashkëkohore dhe të forcimit të mekanizmeve llogaridhënës.

Misioni: frimi i arsimit cilësor për të gjithë nxënësit e komunës së Ferizajt përmes promovimit të mësimdhënies bashkëkohore dhe nxitjes së llogaridhënies.

3.2. Objektivat strategjike dhe masat

Plani Zhvillimor i Arsimit 2018-2022 ka pesë objektiva strategjike, nga një për secilën fushë të analizës, siç është prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Fusha	Objektivi strategjik
1. Menaxhimi i arsimit	S1. Menaxhim efikas i arsimit
2. Sigurimi i cilësisë	S2. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë në institucionet edukativo-arsimore
3. Implementimi i kurrikulës së re	S3. Përgatitje cilësore dhe zbatimi profesional i kurrikulës
4. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	S4. Mësimdhënës të zhvilluar profesionalisht sipas standardeve
5. Infrastruktura shkollore	S5. Mjedis tërheqës dhe i sigurt shkollor

Pra, objektivat strategjike burojnë nga analiza e gjendjes e prezantuar në kapitullin 2 të këtij dokumenti. Nga ana tjetër, ata janë në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara në PSAK 2017-2021.

Nga pasqyra e objektivave strategjike shihet një rrjedhë shumë e mirë e qasjes së zhvillimit të arsimit në Komunën e Gjilanit. anë adresuar elementet kryesore të sistemit por edhe ato më përbajtësore që kanë potencial për të zhvilluar arsimin në Komunë duke pasur parasysh rolin dhe përgjegjësitë e nivelit komunal si dhe potencialin për ndryshim që kanë secila nga këto objektivat. rganizimi i objektivave strategjike është menduar nga vendosja e mekanizmeve adekuatë të menaxhimit, për të vazhduar me aktivitetet rreth sigurimit të cilësisë, zbatimit të

kurrikulës së re, zhvillimit profesional të mësimdhënësve si dhe krijimit të mjedisit të përshtatshëm e të sigurt mësimor.

Secili objektivi strategjik është zbërthyer në masa që janë veprimtari të domosdoshme për arritjen e objektivit, ndërsa për secilin masë është dhënë nga një përshkrim i shkurtër.

KOMUNA
E FERIZAJIT

MENAXHIMI I ARSIMIT DHE ADMINISTRATËS



3.2.1. Menaxhimi dhe administrata

Objektivi Strategjik 1. Menaxhim dhe udhëheqje cilësore e arsimit dhe administratë efektive

Në parim ekziston përceptimi që koncepti i menaxhimit dhe udhëheqjes janë koncepte që mund të definohen në kuptim më të ngushtë dhe më të gjerë. Elemente të menaxhimit dhe udhëheqjes janë shtrirë edhe në fushat e tjera ndërsa në këtë fushë janë adresuar vetëm disa nga elementet që janë konsideruar si prioritet të komunës. Ky plan adreson aspektet e funksionalizimit të këshillave drejtues të shkollave, monitorimin e performancës së shkollës dhe funksionalizimin e mekanizmave për parandalimin e braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve.

Masat

1.1. Funksionalizimi i të gjitha këshillave drejtues të shkollës

Edhe pse plotësimi i anëtarësisë së këshillave drejtues nuk duhet të jetë ndonjë aktivitet sfidues përmbajtësor, funksionaliteti i tyre është i një rëndësie të veçantë dhe po ashtu është edhe sfidues në të njëjtën kohë. Edhe pse ka disa vite që ka hyrë në fuqi rregullativa e re e përbërjes dhe rolit të këshillit drejtues, gjendja në terren nuk ka avancuar në nivelin e duhur. Pra mbetet që DKA-të në bashkëpunim me drejtorët e shkollave në periudhën vijuese të plotësojnë të gjitha këshillat drejtues me anëtarë, e në veçanti me përfaqësuesit e prindërve dhe komunitet në bazë të dispozitave në fuqi. Pastaj, në funksion të fuqizimit të rolit të këshillit, dhe efektshmërisë së punës së tyre, DKA do të punojë me këshillat drejtues të të gjitha shkollave për të hartuar planin e punës dhe të takimeve të këshillave në bazë të të cilave do të orientohej puna e tyre dhe në të njëjtën mënyrë do të monitorohej aktiviteti i tyre.

1.2. Monitorimi i rregullt dhe profesional i institucioneve edukative-arsimore, shkollave nga DKA


Në kuadër të përgjegjësisë së DKA-ve në ofrimin dhe monitorimin e cilësisë së punës së shkollave, DKA riorganizon fushëveprimin e vet duke theksuar edhe më shumë nevojën e monitorimit përmbajtësor dhe profesional duke ikur nga praktika e monitorimeve administrative. Në këtë kuptim, DKA do të hartojë një plan të monitorimit të shkollave dhe cakton personelin përgjegjës brenda DKA-s për këtë punë. DKA monitoron të gjitha shkollat dhe harton raporte të monitorimit, ku identifikohen fushat e përmirësimit për vitet vijuese. Ideja është që ky proces të shërbejë për punën rutinore të DKA-së me shkollat dhe për vetë punën e drejtorisë së shkollës.

1.3. Funksionalizimi i ekipit për parandalimin e braktisjes së shkollimit

Idëja e funksionalizimit të ekipit komunal për parandalimin e braktisjes së shkollimit (EPRMB) shkon përtej hapat të parë të caktimit të anëtarëve dhe themelimit. Pas themelimit, ekipi në bashkëpunim me DKA-në do të hartojë një plan pune i cili përfshin edhe punën e ekipeve shkollore për parandalimin e braktisjes. E gjithë kjo do të bëhet në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ përkatës. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha ekipet shkollore do të realizojnë në vazhdimësi takimet e tyre.

KOMUNA
E FERIZAJIT

SIGURIMI I CILËSISË



3.2.2. Sigurimi i cilësisë

Objektivi Strategjik 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në institucionet edukativo-arsimore

Në përgjithësi, mungesa e mekanizmave të sigurimit të cilësisë është një problem esencial në sistemin e arsimit në Kosovë. Edhe Komuna e Ferizajt e konsideron këtë dimension si të njëj rëndësi të theksuar. Edhe pse sigurimi i cilësisë mund të përceptohet si një koncept më i gjërë, Komuna e Ferizajt ka prioritetuar dy dimensione kryesore të kësaj fushe e që janë përmirësimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik dhe avancimi i monitorimit të punës së mësimdhënësve.

2.1 Funkcionalizimi i shërbimit psikologjik-pedagogjik në shkollë

DKA do të synojë që së paku 80% e shkollave të kenë të instaluar shërbimin psikologjik-pedagogjik dhe të bëhet aftësimi i tyre me qëllim të orientimit të punës së tyre në drejtim të aspekteve profesionale të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në anën tjetër DKA do të jetë më aktive në bashkëpunimin me këtë shërbim dhe do të jetë po ashtu aktive në monitorimin e funksionimit të këtij shërbimi me qëllim të avancimit të punës së tyre.

2.2 Përmirësimi i monitorimit dhe vlerësimit të gjithë mësimdhënësve dhe shkollave

Monitorimi i punës së mësimdhënësve nga ana e drejtorëve të shkollave është esencial për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. DKA do të prioritetizojë avancimin e këtij procesi së pari duke ngritur kapacitetet e drejtorëve të shkollave për monitorim dhe mentorim të mësimdhënësve. Pastaj, do të bëhet planifikimi në nivel shkollash që monitorimi i mësimdhënësve në secilën shkollë të bëhet së paku njëherë në semestër. Një angazhim i tillë doemos do të jetë sfidues për drejtorët e shkollave dhe ata në rastet kur ekziston mundësia do të bashkëpunojnë me zëvendës-drejtorët, pedagogët, koordinatorët e cilësisë dhe aktivet profesionale duke avancuar bashkëpunimin e tyre në nivel shkolle.

KOMUNA
E FERIZAJIT

ZBATIMI I KURRIKULËS SË RE



3.2.3. Zbatimi i kurrikulës së re

Objektivi Strategjik 3. Përgatitja cilësore dhe zbatimi profesional i kurrikulës së re

Tashmë është e qartë që të gjitha shkollat në Komunën e Ferizajt do të përfshihen në zbatimin e kurrikulës së re. Kurriula e re konsiderohet të jetë sfiduese dhe komplekse. Andaj, Komuna e Ferizajt ka planifikuar të adresojë aspektet kryesore të implementimit të kurrikulës duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve për zbatim dhe ofrimin e mjeteve të nevojshme didaktike si parakushte të zbatimit cilësor.

3.1. Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e kurrikulës së re

Në gjendjen aktuale të zbatimit të reformës kurrikulare, ofrimi i mundësive të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në mënyrë të vazhdueshme është esencial në vitet në vijim. DKA angazhohet që të identifikohen grupe të trajnerëve në nivel të secilës shkolle në mënyrë që ata të jenë personat kryesorë në ofrimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional në shkolle. Në afat të shkurtër, të gjithë mësimdhënësit duhet të aftësohen për të punuar me kurrikulën e bazuar në kompetenca. Prioritet do t'i kushtohet mësimdhënësve të klasave 1, 6 dhe 10 në dy vitet e para e mandej do të përfshihen edhe mësimdhënësit tjerë. Për këtë qëllim, duhet të organizohen trajnime sipas fushave lëndore, si dhe aktivitete të zhvillimit profesional në nivel shkolle. Po ashtu, do të organizohen edhe aktivitete të tjera të rregullta në formë të takimeve në të cilat do të ndahen praktikant e mira dhe do të adresohen vështirësitë e hasura gjatë procesit. DKA do të menaxhojë procesin e monitorimit të rregullt të zbatimit të kurrikulës.

3.2. Sigurimi i mjeteve dhe materialeve adekuatë për zbatimin e kurrikulës së re

DKA do të punojë me drejtorinë e shkollave për të identifikuar mjetet didaktike dhe materialet që do të nevojiten për mësimdhënësit në funksion të zbatimit sa më cilësor të kurrikulës së re. Kësisoj do të përcaktohet përbërja e pakove didaktike për secilën shkolle dhe gjatë periudhës së zbatimit të këtij plani të gjitha shkollat do të furnizohen me këto pako.

KOMUNA
E FERIZAJIT

ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE



3.2.4. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Objektivi Strategjik 4. Mësimdhënës të zhvilluar profesionalisht sipas standardeve

Legislacioni në fuqi e ka caktuar zhvillimin profesional të mësimdhënësve si përgjegjësi komunale. Si e tillë, kjo më vete sjell edhe sfidën e menaxhimit të këtij procesi dhe Komuna e Ferizajt planifikon t'i kushtojë vëmendje të theksuar kësaj përgjegjësie. Brenda kësaj fushe, vëmendje e theksuar do t'i kushtohet adresimit të nevojave themelore të mësimdhënësve për zhvillim profesional si dhe informim i regullt dhe i duhur për mundësitë e zhvillimit profesional për të gjithë mësimdhënësit.

4.1. Adresimi i nevojave të mësimdhënësve për zhvillim profesional

DKA do të realizojë një proces të vlerësimit të nevojave për të gjithë mësimdhënësit e Komunës. Ky vlerësim do të bëhet përmes realizimit të një pyetësori me të gjithë mësimdhënësit. Të dhënat që dalin nga pyetësori do të shërbejnë për identifikimin e fushave prioritare që do të adresohen nga komuna në vitet në vijim. Më pas, DKA do të punojë me shkollat që këto nevoja të adresohen qoftë përmes sigurimit të shërbimeve të ofruesve të ndryshëm të akredituar nga MASHT ose përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme me bazë në shkollë.

4.2. Informimi i vazhdueshëm i mësimdhënësve për mundësitë e zhvillimit profesional

Në mënyrë që të gjithë mësimdhënësit të jenë sa më aktiv në zhvillimin e tyre profesional, DKA do të organizojë aktivitete të shumta që shpëjnë në informimin adekuat të mësimdhënësve për mundësitë e ndryshme, por edhe për të shtuar interesimin e mësimdhënësve për pjesëmarrje. Për këtë qëllim, do të përgatiten fletëpalosje që përmbajnë informacione rreth ofertave të ndryshme të organizatave që merren me zhvillim profesional si dhe aktivitetet që organizon vetë komuna. Gjithashtu, do të mbahen takime të shumta për informim të drejtë të të gjithë mësimdhënësve. Këto takime mbahen në nivel të aktiveve profesionale. Planifikohet edhe organizimi dhe realizimi i orëve model nga mësimdhënësit e mirë për t'iu demonstruar praktikën e mira.

KOMUNA
E FERIZAJIT

INFRASTRUKTURA SHKOLLORE



3.2.5. Infrastruktura shkollore

Objekti i Strategjik 5. Krijimi i mjedisit tërheqës dhe të sigurt

Mjaft shumë është investuar në infrastrukturën shkollore në vitet e fundit. Megjithatë ekziston nevoja e avancimit të konceptit të mjedisit shkollor përtej ndërtimit duke përfshirë sigurinë dhe mirëmbajtjen. Komuna e Ferizajt planifikon të ndërtojë së paku tri objekte të reja shkollore, të përmirësojë mirëmbajtjen e hapësirave ekzistuese dhe përmirësimin e sigurisë në shkolla.

5.1. Krijimi i hapësirave adekuate për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore në shkollë

DKA do të bëjë një vlerësim të gjendjes infrastrukturore duke pasur parasysh edhe projektionet e popullacionit të nxënësve dhe nevojat prioritare. Pas identifikimit të prioriteve do të ndërtohen tri objekte të reja shkollore. Po ashtu, do të ndërtohen palestë sportive në të gjitha shkollat që nuk i kanë ato (vetëm 9 shkolla aktualisht kanë palestë sportive).

5.2. Funkcionalizimi i sistemit të sigurisë në të gjitha shkollat

DKA do të bëjë vlerësimin e gjendjes së infrastrukturës së sigurisë në të gjitha shkollat për të konstatuar nevojat e dhe mundësitë. Kjo do të rezultojë në hartimin e një plani për përmirësimin e sigurisë në shkolla. Në bazë të këtij plani do të caktohet për secilën shkollë nëse do të instalohen kamerat, do të rregullohen rrethojat apo të instalohen rojat ose aparatet e fikjes së zjarrit. Kjo varet nga ajo se çfarë kanë shkollat aktualisht.

5.3. Sigurimi i kushteve optimale për higjienën e objekteve edukativo-arsimore

Higjiena në shkolla në përgjithësi është në një nivel jo të kënaqshëm. Megjithatë, për t'u siguruar që kjo çështje adresohet në mënyrën më të mirë të mundshme, DKA në bashkëpunim me drejtorët e shkollave do të bëjë një vlerësim në të gjitha shkollat e komunës për të konstatuar gjendjen, por edhe mundësitë për përmirësim të gjendjes. Në bazë të vlerësimit, DKA siguron mjetet higjienike për të gjitha shkollat. Në anën tjetër DKA do të monitorojë zbatimin e kësaj politike duke ndërrhyrë në rastet kur shkollat nuk përmirësojnë gjendjen e mirëmbajtjes së pastërtisë në shkollë.

3.3. Analiza e rrezikut

Analiza e rrezikut bëhet me qëllim të parandalimit të situatave të papritura që mund ta vënë në rrezik zbatimin e planit strategjik dhe përmban në vete vlerësimin për mundësinë e paraqitjes së një rreziku, të ndikimit që ai rrezik mund të ketë, si dhe elaborimin e masave për parandalimin ose minimizimin e rrezikut. Një analizë e tillë është prezantuar në tabelën 7.

Vlerësimet janë dhënë sipas objektivave strategjikë, duke dalluar tri nivele të gjasës për paraqitjen e rrezikut (“e vogël”, “mesatare” dhe “e madhe”), si dhe tri nivele analoge të ndikimit që rreziku i tillë mund të ketë për zbatimin e planit zhvillimor (“i vogël”, “mesatar”, “i madh”).

Nga tabela shihet se një rrezik të rëndësishë së veçantë paraqet mungesa e përkrahjes nga MASHT për zbatimin e kurrikulës së re meqë ajo shihet si një sfidë e madhe për sistemin arsimor dhe kërkon resurse të konsiderueshme. Po ashtu rrezik i madh shihet edhe mungesa e mjeteve adekuate financiare për të mbuluar koston e pajisjeve didaktike që janë konsideruar të rëndësishme brenda plani zhvillimor.

Në çdo situatë, DKA duhet të bëjë kujdes që analiza e rrezikut të rishikohet në intervale të rregullta kohore, duke i bërë ndryshimet dhe plotësimet e duhura në të, në mënyrë që rreziku të minimizohet sa të jetë e mundshme.

Tabela 7. Analiza e rrezikut për Planin Zhvillimor të Arsimit

Rreziku	Gjasë 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
Presioni nga prindërit për zgjedhjen e drejtimeve në shkollë të mesme	Mesatare	Mesatar	Njofimi dhe vetëdijësimi i prindërve për orientim në karrierë sipas afiniteteve të fëmijës.
Mospjesëmarrja e prindërve në aktivitetet e shkollës	Mesatare	I madh	- Bëhen veprime konkrete për funksionalizimin e KDSH dhe KP, - Organizohen takime të përbashkëta me prindër dhe u bëhen ftesa për pjesëmarrje aktive.
Rritja e braktësjes së shkollimit	E vogël	I madh	- Funksionalizimi i EPRMB në nivel komune. - Organizimi i takimeve të EPRMB një here në muaj. - Bashkëpunimi me institucionet relevante si PK, Enti social, Shkollat mike për fëmijë, etj.
Pamundësia e shfrytëzimit të mjeteve vetanake nga shkollat	E madhe	Mesatar	- Shqyrtohet saktë nevoja për secilën shkollë që krijon të hyra duke kërkuar raport të specifikuar të shpenzimeve nga shkollat. - Pas vlerësimit të nevojave inkurajohen shkollat t'i shpenzojnë mjetet sipas prioriteteve.
Moszbatimi i sistemit të vlerësimit të shkollave nga MASHT	Mesatare	I madh	- Rritet bashkëpunimi Shkollë – DKA – MASHT. - Hartohet plan veprimi për vlerësimin e shkollave në koordinim me MASHT.
Mungesë e mbështetjes adekuate nga MASHT për zbatim të kurrikulës	E madhe	I madh	- Të shohën trajnimet për zbatim të kurrikulës sipas fushave kurrikulare (drejtorët dhe mësimdhënësit). - Bashkëpunohet me ekspertë – OJQ për përgatitje të mire të zbatimit të kurrikulës.
Mungesë e mjeteve financiare për pajisje adekuate, kompjuterë, internet, etj.	I madh	I madh	- Presion në MASHT, vlerësim real të gjendjes së shkollave. - Shqyrtohen të gjitha mundësitë për gjetjen e donacioneve. - Hartohet orari për shfrytëzimin e QNP sipas kërkesave të shkollave.
Mungesë e qendrës shtesë për trajnimin e mësimdhënësve për shkak të numrit të madh të shkollave/ mësimdhënësve	E madhe	I madh	DKA ndan mjete për ZHPM duke funksionalizuar njv qendër të tillë shtesë.

Objekti 2: Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në institucionet edukative arsimore												
Masa 2.1		Funksionalizimi i shërbimit pedagogjik psikologjik në shkollë										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)						
2.1.1	Signurimi i pedagogut/psikologut në shkollë	Duke filluar nga Prill 2018	DKA	Komuna	Angazhimi/punësimi i 6 shërbuesve të konsulentëve nga 380 EUR për 12 muaj 2018: 2 x 12 x 380 = 4,560 x 2 = 9,120 2019: 2 x 380 = 4,560 x 2 = 9,120 2020: 2 x 380 = 4,560 x 2 = 9,120 2021: 2 x 380 = 4,560 x 2 = 9,120 2022: 2 x 380 = 4,560 x 2 = 9,120	2018	2019	2020	2021	2022	Totali	
2.1.2	Trajnimi i pedagogëve për të ofruar shërbime psikologjike në shkollë	Duke filluar nga Prill 2018	DKA	Donatorët	2018: 1 modul x 360 EUR 2019: 1 modul x 360 EUR 2020: 1 modul x 360 EUR		360	360	360		1,080	
2.1.3	Monitorimi i punës së pedagogëve në psikologjive në shkollë	Nga Maj 2018	Drejtorët e shkollave & DKA				x	x	x	x	-	
Nën-Totali 2.1						-	9,480	9,480	9,480	-	28,440	
Masa 2.2												
Përmirësimi i monitorimit dhe vlerësimit të mësimit në shkollë												
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)						
2.2.1	Trajnimi i drejtoreve për monitorimin dhe vlerësimin të mësimit në shkollë	Mars 2018	DKA	Komuna	30 pjesëmarrës x 24 orë (3 ditë) x 0,55 EUR = 396 EUR për një trajnim 3 ditë (një modul) 2018: 3 grupe x 396 = 1,188	2018	2019	2020	2021	2022	Totali	
							1,188	1,188	792	x	3,168	

Masa 1.3												
Funksionalizimi i EPRMB në DKA												
Kodi	Aktiviteti	Implementimi	Përgjegjësia	Institucion/organizata	Përkthimi i kostos		B U X H E T I (EURO)					
1.3.1	Emërimi i anëtarëve të ekipit të EPRMB në nivel komune	gershor 2018	DKA		2018	2019	2020	2021	2022	Totali		
1.3.2	Hartimi i planit të ekipit sipas UA	Prill 2018	DKA									
1.3.3	Përgatitja/ trajnimi i ekipit të DKA dhe ekipëve të shkollave	gershor 2018	DKA	MASHT	396						396	
1.3.4	Mbajtja e takimeve të rregullta me ekipet e të gjitha shkollave	Duke filluar nga gershori 2018 - 4 takime në vit	DKA									
Nën-Totali 1.3												
Totali i Objektivit 1:												
					396	5,400	5,400	5,796	10,800	27,396	396	

Masa 3.2											
Sigurtimi i mjeteve e materialeve adekuate per zbatimin e kurrikules											
Kodi	Aktiviteti	Përdhja e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	2018	2019	2020	2021	2022	Totali
3.2.1	Identifikimi i nevojave për pajisje e mjete funksionale	Duke filluar nga prill 2018	DKA	Drejtorët e shkollave							-
3.2.2	Sigurtimi i mjeteve e pajisjeve funksionale gjatë zbatimit të kurrikulës	Duke filluar nga qershori 2018	DKA	Donatorët	60 shkola x 2000 EUR një pako 2018: 15 pako 2019: 15 pako 2020: 15 pako 2021: 15 pako		30,000	30,000	30,000	30,000	120,000
3.2.3	Monitorimi i rregullit i zbatimit të kurrikulës në secilën shkollë	Duke filluar nga janari 2018	Drejtorët e shkollave	DKA				30,000	30,000	30,000	-
Nën-Totali 3.2							30,000	30,000	30,000	30,000	120,000
Totali i Objektivit 3:						1,400	38,928	41,392	41,392	34,000	157,112

Objekti 4: Mësimdhënës të zhvilluar profesionalisht sipas standardeve												
Masa 4.1		Adresimi i nevojave të mësimdhënësve për zhvillim profesional										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)						
s4.1.1	Zhvillimi i pyetjeve të identifikimit të nevojave të ZHPM	Duke filluar nga maj 2018	KC & DKA			2018	2019	2020	2021	2022	Totali	
	Çakimi i nevojave të ZHPM	Qershor - shtator 2018	KC & DKA									-
	Organizimi i trajnimeve adekuate sipas prioritetve	Janar 2018 - qershor 2021	DKA	Donatorët	30 mësimdhënës x 24 orë (3 ditë) x 0,55 EUR = 396 EUR për një trajnim 3 ditor (një modul) 2018: 10 grupe x 396 EUR = 3960 EUR 2019: 10 grupe x 396 EUR = 3960 EUR 2020: 10 grupe x 396 EUR = 3960 EUR 2021: 10 grupe x 396 EUR = 3960 EUR	2018	2019	2020	2021	2022	15,840	
	Nën-Totali 4.1						-	3,960	3,960	3,960	3,960	15,840
Masa 4.2												
Informimi i vazhdueshëm i të gjithë mësimdhënësve për mundësitë e ZHPM												
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	B U X H E T I (EURO)						
4.2.1	Përgatitja e fletëpalosjeve për ZHPM	Mars 2018	DKA		1520 mësimdhënës x 1 fletëpalosje 1520 x 0,50 EUR = 760 EUR	2018	2019	2020	2021	2022	Totali	760

5. Korniza për vlerësimin e performancës

Ky plan është dokumenti bazë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Komunën e Ferizajt në periudhën 2018-2022. Përgjegësia operative për zbatimin e Planit i takon Drejtorisë Komunale të Arsimit, e cila mund t'i delegojë detyrat tek institucionet arsimore të Komunës, si dhe të bashkërendisë detyrat me dikasteret tjera të Komunës. Ndërkaq, mbikëqyrjen e zbatimit e bën Asambleja Komunale përmes Komitetit për Arsimit, i cili, të paktën një herë në vit shqyrton raportet e DKA për zbatimin e Planit.

Korniza për vlerësimin e performancës përcakton treguesit mbi bazën e të cilëve do të vlerësohet progresi për secilin nga pesë objektivat e planit zhvillimor dhe si e tillë përmban caqet që duhet arritur gjatë periudhës së zbatimit të Planit, si dhe gjendjen e tanishme të treguesve. Kjo kornizë është prezantuar në vijim, në formë të pesë tabelave, nga një për secilin objektiv strategjik.

OS1. Menaxhim dhe udhëheqje cilësore e arsimit dhe administratë efektive			
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku	
Numri i anëtarëve të secilit këshill në secilën shkollë	470	Sipas UA në fuqi	
Numri i shkollave të trajnuara për KDSH	5	80% e shkollave	
Numri i punëtorëve profesionistë në DKA	10	15	
Përqindja e orëve të monitoruara nga drejtorët e shkollave	55.76%	Sipas standardeve të përcaktuara me kontratë	
Numri i monitorimeve të DKA-së në shkolla brenda një viti	47	80% e shkollave	
Numri i takimeve të EPRMB me ekipet e shkollave	0	4 herë brenda vitit	

OS2. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë në institucionet edukative-arsimore			
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku	
Numri i pedagogëve e psikologëve të punësuar në shkolla	15	80% e shkollave kanë pedagog/psikolog	
Numri i monitorimeve/ intervistave të drejtorëve me këta persona	Në vazhdimësi përcillet puna nga drejtorët e shkollave	Mbi 70% e drejtorëve përcjellin punën e shërbyesve të konsulencës	
Numri i drejtorëve të trajnuar për udhëheqje në arsim	47	Të gjithë drejtorët trajnohen për udhëheqje dhe për VPM	
Numri i orëve të monitoruara në secilën shkollë, nga drejtorët	900	Secili mësimdhënës i secilës shkollë monitorohet së paku një herë gjatë gjysmëvjetorit	

Numri i dosjeve/protokolleve të monitorimit të secilës shkollë	1614	Secili mësimdhënës ka dosjen personale të monitorimeve të drejtori
--	------	--

OS3. Përgatitje cilësore dhe zbatim profesional i kurrikulës së re			
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku	
Numri i trajnerëve për 7 fushat në nivel komune	15	SIPAS MASHT	
Numri i mësimdhënësve të trajnuar për kurrikulën e re	548	100% sipas shkollave, dhe planifikimit	
Numri i takimeve, procesverbaleve për fushat kurrikulare në komunë	Tri shkolla që janë në proces të pilotimit të KKK, janë monitoruar vazhdimisht	4 herë në vit	
Numri i pakove didaktike në nivel komunal		Së paku nga 1 pako për secilën shkollë	
Numri i monitorimeve të shkollave nga DKA për zbatimin e kurrikulës	130	Së paku 2 herë në vit secila shkollë	

OS4. Mësimdhënës të zhvilluar profesionalisht sipas standardeve			
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku	
Numri i mësimdhënësve të trajnuar në komunën e Ferizajt	90%	100%	
Numri i orëve të ZHPM në nivel komune - mesatarja	9000	Të paktën 10,000 orë në vit	
Numri i prezantimeve në aktive profesionale në nivel komune	0	Të paktën 28 prezantime për 7 fushat	
Numri i orëve model të realizuara në nivel shkolle e komune	0	Të paktën 150 orë model	

OS5. Mjedis tërheqës dhe i sigurt shkollor			
Treguesi	Gjendja e tanishme	Caku	
Numri i objekteve shkollore	63	Sipas planifikimit	
Numri i anekseve sportive	9	Të gjitha shkollat kanë palestër sportive	

Numri i shkollave të pajisura me sistemin e sigurisë	63	Të gjitha shkollat kanë sistemin e sigurisë - kamerat
Numri i shkollave të pajisura me aparate të fikjes së zjarrit dhe plane emergjente	7	Të gjitha institucionet edukative-arsimore
Raportet e kontrollit sanitar në të gjitha shkollat	Janë të pajisura 7 shkolla të reja	Raport për secilën shkollë

Shtojcë 1: Pjesëmarrësit në procesin e planifikimit

1. Adem Muhaxheri
2. Afim Llabjani
3. Aflore Lila
4. Bashkim Bytyqi
5. Blerim Saqipi
6. Fadil Sejdiu
7. Fatushe Azemi
8. Ganimete Konjufca
9. Halit Grainca
10. Imri Musliu
11. Mehmet Murseli
12. Ramadan Balius
13. Sadete Lohaj
14. Sadije Hajdini
15. Sinavere Hoxha
16. Shafie Hajdari
17. Zuhail Avdullahi
18. Zymryte Berisha



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

